

Statuti i Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë “Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar”

(i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve)

Me Vendimin Nr. 125 datë 29.06.2017

“Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar” (në vijim, “Instituti” dhe/ose “IEKA”) është organizimi profesional i cili grupon audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me Ligjin nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, ndryshuar me ligjin nr.10297 date 08.07.2010 Për një ndryshim në ligjin nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar" dhe me ligjin 47/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", të ndryshuar. (në vijim i quajtur “Ligji”).

IEKA është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 3573 datë 16.10.1998 si organizatë jofitimprurëse me antarësi. Veprimtaria e tij/saj realizohet në përputhje me Legjislacionin në fuqi dhe me këtë statut, dhe mbikëqyret nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike të Audituesve Ligjorë .

KAPITULLI I

Emërtimi - Objekti

Neni 1

Emri i organizatës profesionale është “Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar” (shkurtimisht “IEKA”). Selia e Institutit ndodhet në adresën: Rruga e Elbasanit, Pallati Edil Al-It, kati 3^{-të}, Zyra 321, Tiranë. Instituti ka vulën dhe stemën të cilat shoqërojnë të gjithë dokumentacionin e tij. Stema (logo) e Institutit përmban figurën e një peshoreje me dy krahë të balancuar, e cila vendoset përpara emrit të shkurtuar IEKA, i cili pasohet nga emri i plotë “Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë.

Neni 2

2.1 Objekti i veprimtarisë së Institutit është të mbrojë pavarësisë dhe nderin e audituesve ligjorë, anëtarë të Institutit dhe të sigurojë se gjatë kryerjes së shërbimeve për klientët, ata gjithnjë do të mbajnë parasysh dhe do të veprojnë në përputhje me interesat e publikut.

IEKA ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

2.1.1 Të hartojë programet e përgatitjes dhe të formimit profesional të kandidatëve për auditues

ligjorë, të organizojë dhe monitorojë procesin e përgatitjes dhe formimit profesional të kandidatëve;

2.1.2 Të hartojë rregullat e stazhit profesional për kandidatët që ndjekin programin e përgatitjes profesionale për marrjen e titullit Auditues Ligjor;

2.1.3 Të hartojë programin e kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve, të organizojë Kualifikime të anëtarëve, dhe të kryejë monitorimin në rastet kur kualifikimet organizohen nga palët e treta;

2.1.4 Të organizojë sistemin e kontrollit të cilësisë së punës së audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, në rastet kur kjo detyrë, i delegohet Institutit nga Bordi i Mbikqyrjes Publike, të kryejë investigime të nevojshme për rastet e shkeljeve të standardeve teknike dhe të etikës profesionale, si dhe të udhëheqë sistemin e investigimit e të disiplinës për aspekte të tjera brenda objektit të vet;

2.1.5 Të vendosë dhe të mbajë marrëdhënie me Bordin e Mbikqyrjes Publike të profesionit për të gjitha çështjet që parashikohen në ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit.

2.1.6 Të vendosë dhe të mbajë marrëdhënie me Komisionin e Provimeve dhe me Komitete e Komisione tjera që krijohen në zbatim të ligjit, statutit apo rregullave të tjera të brendshme për të gjitha çështjet që lidhen me këto komisione apo komitete.

2.1.7 Të antarësohet në organizata ndërkombëtare të profesionit dhe të udhëheqë veprimtarinë për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo anëtarësi;

2.1.8 Të mbajë dhe të përditësojë regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe të shoqërive të audituesve ligjorë;

2.1.9 Të paraqesë tek organet dhe institucionet shtetërore çdo informacion për profesionin në bazë të të cilit janë organizuar anëtarët e vetë, si dhe të paraqitet kur thirret nga këto organe e autoritete për çështje që lidhen me profesionin e audituesit ligjor;

2.1.10 Të sigurojë se anëtarët e profesionit të audituesit ligjor zbatojnë praktikën më të mirë në fushën e standardeve profesionale teknike dhe të etikës;

2.1.11 Të hartojë aktet vetërregullatore dhe/ose akte të tjera nënligjore në zbatim të ligjit, të cilat i nënshtrihen sipas rastit miratimit, nga Bordi i Mbikqyrjes Publike, apo autoritete të tjera;

2.1.12 Të zhvillojë veprimtari shkencore në shërbim të profesionit duke përpunuar e publikuar udhëzues specifikë që lidhen me zbatimin e standardeve të auditimit dhe rekomandime me natyrë teknike, profesionale apo etike, në fushën e auditimit, të dhënies së sigurisë, kontabilitetit e fusha të tjera të ngjashme.

2.1.13 Të kryejë çdo detyrë tjetër që është brenda objektit të veprimtarisë të përcaktuar në ligj dhe në këtë statut;

KAPITULLI II

Cilësia, të drejtat dhe detyrimet e Anëtarit të Institutit

Neni 3

3.1 Instituti grupon të gjithë audituesit ligjorë dhe shoqëritë e audituesve ligjorë të cilat janë regjistruar si të tilla në përputhje me legjislacionin në fuqi, për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe/ose të konsoliduara të shoqërive tregtare dhe të entiteteve të tjera në Republikën e Shqipërisë.

3.2 Përfshirja në regjistrin publik të Institutit humbet në momentin që audituesi ligjor ose shoqëria e audituesve ligjorë fshihet përfundimisht nga ky regjistër, në zbatim të rasteve të parashikuara në nenin 26 të Ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009 (i ndryshuar).

3.3 Anëtarët e Institutit nuk mund të mbajnë njëkohësisht më shumë se një funksion në organet e zgjedhura të Institutit, përveçse rasteve kur kjo parashikohet nga ligji dhe ky statut.

3.4 Në organet e zgjedhura të Institutit dhe në komitetet apo komisionet që ngrihen për çështje të caktuara nuk mund të jenë dy ose më shumë ortakë nga e njëjta shoqëri audituese.

Neni 4

4.1 Anëtarë të Institutit janë të gjithë audituesit ligjorë të regjistruar në Regjistrin Publik të Audituesve ligjorë për të ushtruar profesionin në praktikën publike. Instituti i pajis anëtarët e tij me kartë anëtarësie, e cila përmban të dhëna për individin. Kjo kartë bëhet e pavlefshme dhe dorëzohet në Institut në momentin e crregjistrimit nga Regjistri Publik.

4.1.(a) IEKA publikon në një aneks të veçantë të regjistrit publik të audituesve ligjorë, të gjithë individët të cilët kanë mbushur moshën për të dalë në pension, por sipas nenit 26 pika 1, shkronja "e", të Ligjit 10091 , të ndryshuar, kanë vendosur të punojnë dhe janë të regjistruar pranë një shoqërie të audituesve ligjorë, e cila ka më shumë se dy ortakë angazhimi auditimi, për të kryer angazhime auditimi nën përgjegjësinë e shoqërisë së auditimit.

4.2 Vetëm anëtarët e Institutit mbajnë titullin Auditues Ligjor.

4.3 Këshilli Drejtues i Institutit vendos dhënien e titujve honorifike për anëtarët e dalë në pension, të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar për profesionin e audituesit ligjor.

Neni 5

5.1 Anëtarët e Institutit kanë të drejtë:

5.1.1 të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e Institutit.

5.1.2 të informohen mbi veprimtarinë e Institutit dhe administrimin e tij.

5.1.3 të kenë mbrojtje dhe mbështetje profesionale nga ana e Institutit.

5.1.4 të angazhojnë kandidatë për auditues ligjorë

5.2 Anëtarët e Institutit kanë këto detyrime:

5.2.1 të respektojnë kërkesat ligjore, nënligjore, statutore dhe të rregulloreve të Institutit, të zbatojnë standardet profesionale dhe Kodin e Etikës të IFAC të miratuar nga IESBA dhe Kodin e Etikës të IEKAs të miratuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

5.2.2 të shlyejnë në afatet e caktuara kuotat profesionale të anëtarësisë.

5.2.3 të zbatojnë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Këshillit Drejtues

5.2.4 të marrin pjesë në veprimtaritë kualifikuese dhe veprimtari të tjera të organizuara nga Instituti.

5.3 Anëtarë me të drejtë vote në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme do të jenë të gjithë anëtarët e Institutit, të cilët në datën e njoftimit për thirrjen e Asamblesë janë të regjistruar në Regjistrin publik të Audituesve Ligjorë dhe e ushtrojnë profesionin në praktikën publike.

Neni 6

Në rastet kur do të ndërmarrë një veprimtari të re, në përputhje me nenin 23 të Ligjit, audituesi ligjor, anëtar i IEKAs, i drejtohet Institutit me një kërkesë me shkrim ku kërkon pezullimin e përkohshëm nga regjistri publik i audituesve ligjorë e cila shqyrtohet dhe miratohet në përputhje me dispozitat e Ligjit.

Neni 7

7.1 Çdo auditues ligjor person fizik dhe cdo shoqëri auditimi do të dorëzojë në Institut, në formatin hardcopy dhe në mënyrë elektronike deri më datë 25 janar të cdo viti, pasqyrën e deklaratimit të misioneve, sipas një pasqyre që përmbledh, sipas kategorive, veprimtaritë/ misionet që ka kryer gjatë vitit paraardhës, si dhe honoraret e faturuara, sipas formatit të miratuar nga Këshilli Drejtues, si dhe deri në datën 31 mars të cdo viti pasqyrat financiare të vitit të mbyllur, të nënshkruara.

KAPITULLI III

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve

Neni 8

8.1 Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve është organi më i lartë vendimmarrës i Institutit. Ajo ka kompetencat e mëposhtme:

- përcakton dhe orienton politikën e përgjithshme të Institutit,
- zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues,
- zgjedh dhe shkarkon anëtarët e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm,
- emëron dhe shkarkon audituesin ligjor të Pasqyrave Financiare të Institutit, bazuar në propozimin e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm,
- shqyrton raportet e paraqitura nga organet e mësipërme,
- miraton rregulloret profesionale, dhe çdo rregullim tjetër të përgjithshëm,
- miraton shpërblimet për personat e zgjedhur në organet drejtuese të Institutit,
- miraton buxhetin vjetor të Institutit,
- miraton skemën e kuotave të anëtarësisë,
- shqyrton dhe miraton Pasqyrat Financiare të Institutit,
- autorizon transferimin, disponimin ose ngarkimin me barrë të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të Institutit,
- miraton ndryshimet e statutit.

8.2 Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve vendos dhe për çdo çështje tjetër të përfshirë në rendin e ditës brenda afateve të parashikuara nga statuti.

Neni 9

9.1 Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme e Anëtarëve thirret nga Kryetari i Këshillit Drejtues dhe mbledhet nga një deri në dy herë në vit, respektivisht në muajt Qershor dhe Dhjetor. Objekti i Mbledhjes së Asamblesë së zakonshme janë shqyrtimi i veprimtarisë vjetore të Këshillit Drejtues dhe Komitetit të Kontrollit të Brendshëm, çështje të tjera që lidhen me veprimtarinë e

Instituti, përfshirë zgjedhjet e radhës të anëtarëve në organet Drejtuese.

9.2 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret jashtë radhës së parashikuar në nenin 9.1 të statutit, sa herë që konsiderohet e nevojshme për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Institutit. Në këtë rast ajo thirret nga Kryetari i Këshillit Drejtues ose në mungesë të tij, nga Zv.Kryetari: me kërkesë të Kryetarit të Komitetit të Kontrollit të Brendshëm; nga një e katërta e anëtarëve të Institutit, ose me vendim të Bordit të Mbikëqyrjes Publike të profesionit.

9.3 Rendi i ditës së Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve caktohet nga Kryetari i Këshillit Drejtues, dhe në mungesë të tij nga zv/kryetari, i cili merr parasysh edhe propozimet e palëve të interesuara për thirrjen e saj sipas pikës 9.5 më poshtë, dhe i njoftohet anëtarëve të paktën 25 ditë përpara datës së mbledhjes.

9.4 Njoftimi i rendit të ditës bëhet nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të internetit të IEKAs ose nëpërmjet postës elektronike. Në njoftim përcaktohen data, ora dhe vendi ku do të zhvillohet mbledhja.

Kur Asambleja thirret në pajtim me rastet e parashikuara nga nenet 17.2, 23.3, 24.6 dhe 24.8, afati i njoftimit i përcaktuar më sipër mund të reduktohet në 10 ditë.

9.5 Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve shqyrton vetëm çështjet e përcaktuara në rendin e ditës. Kryetari i Këshillit Drejtues është i detyruar të përfshijë në rendin e ditës çështjet që atij i janë paraqitur nga Kryetari i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm, nga një e katërta e anëtarëve të Institutit dhe/ose në kërkesën për mbledhje të formalizuar me vendim të Bordit të Mbikëqyrjes Publike jo më vonë se 35 ditë para datës së mbledhjes.

Neni 10

Kur Asambleja e Përgjithshme e zakonshme e Anëtarëve përfshin në rendin e ditës edhe zgjedhjen e anëtarëve të organit apo organeve të Institutit, votimi është individual dhe anëtarët nuk mund të përfaqësohen në mbledhjet e Asamblesë nga një anëtar tjetër i pajisur me prokurë apo autorizim.

Në rastet e votimit për çështje të tjera që lidhen me veprimtarinë e Institutit, një anëtar i Institutit mund të përfaqësohet në Asamblesë nga një anëtar tjetër i pajisur me prokurë të posaçme për përfaqësimin e tij në një mbledhje. Çdo anëtar ka të drejtën të përfaqësojë deri në katër anëtarë.

Neni 11

11.1 Mbledhja e Përgjithshme drejtohet nga një Komitet prej tre anëtarësh, ku bën pjesë, Kryetari i Këshillit Drejtues, anëtari me moshën më të madhe dhe anëtari me moshën më të vogël. Në rast pamundësie, dy anëtarët caktohen sipas radhës zbritëse të moshës respektive.

11.2 Për mbajtjen e proces-verbalit të mbledhjes së asamblesë caktohen deri në dy sekretare midis anëtarëve të stafit ekzekutiv të Institutit.

11.3 Në çdo mbledhje të Asamblesë, mbi bazën e propozimeve të hapura, zgjidhet Komisioni i Votimit i cili përbëhet nga 3 anëtarë, të cilët nuk mund të zgjidhen midis anëtarëve të Këshillit

Drejtues, anëtarëve të Komitetit të Kontrollit të Brendshëm apo kandidatëve që marrin pjesë në zgjedhjet për organet drejtuese.

Neni 12

12.1 Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve merr vendime të vlefshme vetëm kur në mbledhjen e parë është i pranishëm fizikisht dhe me të drejtë përfaqësimi, një kuorum i barabartë me gjysmën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve me të drejtë vote. Nëse në mbledhjen e parë ky kuorum nuk arrihet, kryetari thërret një mbledhje të dytë me të njëjtin rend dite, e cila duhet të mbahet jo më herët se 10 ditë pas datës së mbledhjes së parë. Në këtë mbledhje nuk kërkohet plotësimi i kuorumit.

12.2 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, të cilat merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe të përfaqësuar me të drejtë vote, janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët aktivë që e ushtrojnë profesionin, anëtarët që janë tërhequr apo nuk e ushtrojnë profesionin dhe kandidatët.

12.3 Votimi është i fshehtë, me përjashtim të rasteve kur në këtë statut është parashikuar ndryshe dhe mund të realizohet edhe në mënyrë elektronike.

Neni 13

13.1 Kur Asambleja e Përgjithshme e zakonshme e Anëtarëve ka në rend dite zgjedhjen e anëtarëve të organit apo organeve të Institutit, Kryetari i Këshillit Drejtues duhet të njoftojë anëtarët për këtë rend dite të paktën 30 ditë përpara datës së mbledhjes duke përmendur vendet vakante në organet që do të jenë objekt votimi.

13.2 Kandidaturat duhet t'i paraqiten Kryetarit të Këshillit Drejtues të paktën 20 ditë përpara datës së mbledhjes dhe duhet të kenë miratimin me shkrim e të paktën pesë anëtarëve të Asamblesë.

13.3 Nuk mund të zgjidhen në organet e Institutit:

13.3.1 Anëtarët që në datën e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve nuk kanë shlyer kuotën fikse të anëtarësisë,

13.3.2 Anëtarët të cilët prej tre vjetëve përpara datës së mbledhjes kanë qënë subjekt i një mase disiplinore sipas nenit 55 të Ligjit.

13.3.3 Dy apo më shumë anëtarë të cilët kanë paraqitur kandidaturën për t'u zgjedhur në organet drejtuese të tij dhe kanë ose për një periudhë prej jo më pak se katër vitesh, kanë qënë ortak angazhimi me ose pa pjesëmarrje në kapital, në të njëjtën shoqëri auditimi.

13.4 Kandidatëve për anëtarë të KD-së ju ndalohet cdo veprimtari publicitare, që mund të jetë në formën e fushatës për zgjedhje apo edhe në forma të tjera, pasi bie në kundërshtim me kodin e etikës, ku anëtarëve ju ndalohet të bëjnë publicitet personal.

13.5 Kandidatët për organet drejtuese të IEKAs kanë të drejtë të paraqesin objektivat e tyre me

shkrim ose me gojë. Mënyra e paraqitjes rregullohet me një Rregullore të veçantë që miratohet me vendim të Këshillit Drejtues.

Neni 14

14.1 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, së bashku me diskutimet e zhvilluara në mbledhje pasqyrohen në një proçesverbal i cili mbahet nga sekretaria dhe nënshkruhet bashkërisht nga Kryetari i mbledhjes, sekretari dhe anëtarët e Komisionit të Votimit.

14.2 Çdo anëtar i Institutit mund të pajiset me kopje të këtij proçesverballi. Proçesverbalet e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve mbahen pranë selisë së Institutit.

KAPITULLI IV Këshilli Drejtues

Neni 15

15.1 Këshilli Drejtues kryen drejtimin e veprimtarisë së Institutit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe rregullatore në fuqi, me këtë statut si dhe me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, të cilës dhe i raporton për veprimtarinë e tij.

15.2 Këshilli Drejtues ka kompetencat e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to:

15.2.1 Harton dhe miraton programet e përgatitjes dhe të formimit profesional të hyrjes në profesion të kandidatëve, organizon dhe monitoron proçesin e përgatitjes dhe formimit profesional të kandidatëve.

15.2.2 Organizon zhvillimin e moduleve profesionale për kandidatët dhe të tjerë të interesuar në njohuritë dhe zotësitë që mbuloohen nga modulet profesionale të raportimit financiar, auditimit e dhënies së sigurisë, manaxhimit të performancës, taksave e tatimeve, legjislacionit të biznesit penal, etj.

15.2.3 Harton rregullat e praktikës profesionale, të cilat miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.

15.2.4 Harton programet e kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve, organizon kualifikimin në rastet kur ai kryhet nga Instituti si dhe udhëheq monitorimin e trajnimeve në rastet kur ato organizohen nga palë të treta.

15.2.5 Organizon sistemin e kontrollit të cilësisë së punës së audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, sa herë që kjo e drejtë i delegohet nga Bordi i Mbikqyrjes Publike, kryen investigimet e nevojshme për rastet e shkeljeve të standardeve teknike dhe të etikës profesionale, si dhe udhëheq sistemin e investigimit e të disiplinës

15.2.6 Mund të asistojë Bordin e Mbikqyrjes Publike në rastet kur ai kryen investigime për audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese;

15.2.7 Mban marrëdhënie me Bordin e Mbikqyrjes publike të profesionit për të gjitha çështjet që parashikohen në ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të ligjit.

15.2.8 Përfaqëson nëpërmjet Kryetarit të Këshillit Drejtues Institutin në organizatat ndërkombëtare të profesionit dhe siguron përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësia;

- 15.2.9 Mbikëqyr nëpërmjet Kryetarit mbajtjen e rregullt dhe të përditësuar të regjistrit publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese.
- 15.2.10 Përfaqëson nëpërmjet Kryetarit të Këshillit Drejtues Institutin tek organet dhe institucionet shtetërore, dhe tek palët e treta, mban lidhje me to dhe paraqitet kur thirret nga këto organe e autoritete për çështje që kanë të bëjnë me profesionin.
- 15.2.11 Siguron që anëtarët e Institutit zbatojnë praktikat më të mira në fushën e standardeve profesionale dhe të Etikës.
- 15.2.12 Përgatit aktet vetërregullatore dhe/ose akte të tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji, të cilat i nënshtrohen miratimit të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve dhe sipas rastit, bordit të mbikëqyrjes publike dhe/ose Ministrit të Financave.
- 15.2.13 Këshilli Drejtues vendos për çdo çështje të rëndësishme që i intereson profesionit të audituesit ligjor në periudhën midis dy mbledhjeve të asamblesë.
- 15.2.14 Miraton rregulloren e brendshme dhe organigramën e Institutit.
- 15.2.15 Mban përgjegjësi për administrimin e pasurisë së Institutit, ka të drejtë të disponojë dhe tjetërsojë atë në bazë të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, si dhe të lidhë kontratat përkatëse për veprimet e mësipërme.
- 15.2.16 Siguron funksionimin e rregullt të Institutit dhe bashkërendimin e veprimtarisë së organeve të tij.
- 15.2.17 Monitoron punën e stafit ekzekutiv në zbatimin e buxhetit të Institutit,
- 15.2.18 Përcakton tabelat që do t'i paraqiten Bordit të Mbikqyrjes Publike me treguesit në lidhje me afatet kohorë të auditimit ligjor.
- 15.2.19 I paraqet për miratim Asamblesë rregulla specifike lidhur me tarifën orare normale për kryerjen e auditimit ligjor.
- 15.2.20 Kryen studime, dhe veprimtari të tjera të ngjashme, brenda kompetencës së tij, kur ato kërkohen nga Asambleja apo edhe organet ose autoritetet shtetërore.
- 15.2.21 Ushtron nëpërmjet Kryetarit të Këshillit Drejtues përpara çdo gjykate të gjitha të drejtat e palës civile lidhur me faktet që i sjellin dëm drejtpërdrejt a tërthorazi, interesave kolektive të profesionit.
- 15.2.22 Arbitron dhe zgjidh me pajtim çdo konflikt ose mosmarrëveshje të karakterit profesional.
- 15.2.23 Zgjedh midis anëtarëve të Këshillit Drejtues që kanë të drejtë të zgjidhen në këto pozicione, Kryetarin dhe zv/kryetarin.
- 15.2.24 Emëron dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv të Institutit.
- 15.2.25 I propozon Bordit të Mbikqyrjes Publike formulën dhe masën e shpërblimit për anëtarët e Komisionit të provimeve të aftësisë profesionale, komisioneve dhe të komiteteve të tjera të krijuara në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
- 15.2.26 Pranon ose refuzon dhurimet në favor të Institutit
- 15.2.27 Autorizon transferimin e zërave të buxhetit përpara kryerjes së shpenzimeve deri në masën 25 % të zërit përkatës.

Neni 16

16.1 Këshilli Drejtues përbëhet nga 7 anëtarë të cilët janë Kryetari, Zëvendëskryetari dhe 5 anëtarë përgjegjës për çështje të tjera, të ndara sipas fushës profesionale.

16.2 Anëtarët e Këshillit Drejtues, zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve për një

periudhë katërvjecare.

Në zbatim të Ligjit 10091 ndryshuar me ligjin 47/2016, tre anëtarë, të zgjedhur për mandatin 2015-2019, të cilët përzgjidhen me short nga Këshilli Drejtues midis anëtarëve ekzistues, përfitojnë një zgjatje të mandatit edhe për dy vjet, pra deri në fund të vitit 2021. Anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues, kanë të drejtë të zgjidhen, vetëm pasi të kenë kaluar katër vjet nga zgjedhja e tyre e mëparshme. Kryetari dhe zëvendëskryetari, nese nuk perfitojne zgjatje mandati ne cilesine e anetarit, kanë të drejtë të kandidojnë ne zgjedhjet e radhes për t`u zgjedhur anëtarë të Këshillit Drejtues.

Nuk mund te zgjidhen respektivisht Kryetar apo zëvendëskryetar, anetaret e KD-se, te cilet kane sherbyer me pare, ne pozicionet respektive per dy mandate katërvjeçare.

16.3 Zgjedhjet e anëtarëve të Këshillit Drejtues bëhen nga Asambleja e Përgjithshme, me votim të fshehtë, në bazë të paraqitjes individuale të kandidaturës.

16.4 Kandidaturat për të plotësuar vendet vakante që krijohen në Këshillin Drejtues duhet të paraqiten pranë Kryetarit të Këshillit Drejtues të paktën 25 ditë përpara datës kur është thirrur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme e Anëtarëve, e cila ka në rendin e ditës zgjedhjen e anëtarëve.

16.5 Asambleja do të votojë për të zgjedhur anëtarët e Këshillit Drejtues. Do të zgjidhen anëtarë të Këshillit Drejtues aq anëtarë, sa është numri i anëtarëve vakante, për shkak të mbarimit të afatit kohor, të përcaktuar sipas Ligjit 10091, të ndryshuar dhe këtij statuti. Anëtarë të këshillit zgjidhen kandidatët të cilët në votim kanë marrë numrin më të madh të votave.

16.6 Në mbledhjen e parë, Këshilli Drejtues i plotësuar me 7 anëtarë, në ato raste kur mandati i kryetarit apo zv/kryetarit, ka përfunduar, zgjedh midis anëtarëve që kanë të drejtë të zgjidhen në këto poste kryetarin apo zv/kryetarin.

16.7 Anëtarët e rinj të Këshillit Drejtues të zgjedhur organizojnë mbledhjen e konstituimit të Këshillit të ri në ditën e parë të muajit pasardhës pas zgjedhjes së tyre. Në seancën hapëse të kësaj mbledhje janë të ftuar të marrin pjesë edhe anëtarët e mëparshëm të Këshillit Drejtues.

16.8 Në rast pamundësie apo pengimi të Kryetarit, funksionet e tij ushtrohen nga Zv. Kryetari dhe në mungesë të këtij të fundit nga anëtari i Këshillit me më shumë vite eksperiencë në profesionin e audituesit ligjor.

Neni 17

17.1 Në rast vdekje, pengimi ose dorëheqje të një anëtari të Këshillit Drejtues, ky i fundit mund të zëvendësohet deri ne kryerjen e zgjedhjeve të ardhshme, nga një anëtar tjetër i Institutit i cili ka paraqitur kandidaturën në zgjedhjet me te fundit dhe ka fituar numrin me të madh të votave pas kandidatëve të zgjedhur si anëtarë.

17.2 Në rast vdekje ose pengimi apo dorëheqje të më shumë se 2 anëtarëve të Këshillit Drejtues, Asambleja e Përgjithshme e radhës (Qershor ose Dhjetor) e Anëtarëve sipas përcaktimit të nenit 9.4

të këtij statuti do të zgjedhë anëtarët që mungojnë, përfshirë dhe anëtarin e cili është zëvendësuar në mënyrë të përkohshme sipas paragrafit të mësipërm, nëse ka të tillë. Proçedura për njoftimin dhe paraqitjen e kandidaturave në këtë rast nuk do të jetë ajo e parashikuar në nenin 13.1 dhe 13.2 të këtij statuti. Ato do t'i paraqiten Kryetarit të Këshillit Drejtues menjëherë pas njoftimit të rendit të ditës deri në ditën e mbledhjes së Asamblesë.

17.3 Mandati i anëtarëve të rinj të zgjedhur sipas paragrafit 17.2 përfundon së bashku me mandatin e anëtarëve të zgjedhur më parë, të cilin ata zëvendësojnë.

Neni 18

18.1 Këshilli Drejtues mblidhet mbi bazën e njoftimit me shkrim të Kryetarit, sa herë që e kërkojnë interesat e Institutit dhe jo më pak se një herë në muaj. Në njoftim përcaktohet rendi i ditës, vendi dhe ora e mbledhjes, dhe njoftimi shoqërohet me dokumentet e nevojshme. Njoftimi për mbledhjen e Këshillit duhet të bëhet të paktën pesë ditë kalendrike para mbledhjes. Në rast mbledhje të Këshillit Drejtues për arsyet e parashikuara në nenin 23.3 të këtij statuti ky afat mund të jetë 3 ditë.

18.2 Kryetari e thërret Këshillin në mbledhje kur ka një kërkesë me shkrim të paktën tre anëtarë të tij. Kjo kërkesë përcakton çështjet për t'u përfshirë në rendin e ditës. Mbledhja duhet të zhvillohet jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së kërkesës.

Neni 19

19.1 Mbledhjet e Këshillit drejtohen nga Kryetari ose në mungesë të tij nga Zv. Kryetari. Në rast të mungesës së njërit dhe të tjetrit mbledhja kryesohet nga anëtari i Këshillit me më shumë vite eksperiencë në profesionin e audituesit ligjor.

19.2 Këshilli Drejtues mund të marrë vendime të vlefshme kur në mbledhje janë të pranishëm jo më pak se pesë anëtarë. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në rast votash të barabarta ajo e Kryetarit është përcaktuese.

Neni 20

20.1 Vendimet e Këshillit pasqyrohen në një proçesverbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari ose, në qoftë se ai ka pengesa apo është në pamundësi të ushtrojë funksionet e tij, nga Zv. Kryetari dhe nga personi i cili është ngarkuar për mbajtjen e proçesverbalit. Proçesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Drejtues ruhen në selinë e Institutit.

20.2 Vendimet reflektojnë rezultatin e votimit dhe firmosen nga të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues.

Neni 21

21.1 Për të adresuar çështje të caktuara ose për të përmbushur detyra specifike, Këshilli Drejtues mund të krijojë komitete të përkohshme ose të përhershme

21.2 Këshilli mundet, gjithashtu, të krijojë komisione ose grupe pune teknike që ai gjykon të dobishme e për të përmbushur objektin e Institutit. Këshilli Drejtues mund të ftojë persona jo anëtarë të Institutit për të marrë pjesë në këto komisione ose grupe pune.

Neni 22

Kryetari i Këshillit Drejtues është organi që përfaqëson Institutin.

Neni 23

23.1 Funkzioni i anëtarit të Këshillit Drejtues përfundon kur :

- Anëtarit i mbaron afati ligjor /Statutor për të shërbyer në Këshill;
- Pushon së qeni anëtar i Institutit; ose
- Është objekt i një ndëshkimi disiplinor me pezullim për një periudhë kohe të caktuar.

23.2 Anëtarët e Këshillit Drejtues mund të shkarkohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve në ato raste kur veprimet apo mosveprimet e tyre, të cilat bien ndesh me statutin, ligjin dhe rregullat kanë dëmtuar rëndë reputacionin e profesionit të audituesit ligjor dhe të organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

23.3 Një anëtar i Këshillit Drejtues shkarkohet nga kjo detyrë kur ai mungon në mënyrë të paarsyeshme në katër mbledhje të njëpasnjëshme të Këshillit Drejtues. Kryetari i Këshillit e fton anëtarin mungues që të shpjegohet në mbledhjen vijuese të Këshillit. Në qoftë se anëtari mungues nuk paraqitet në këtë mbledhje ose kur Këshilli nuk i pranon arsyet e paraqitura nga ky i fundit, anëtari pezullohet dhe shkarkimi i këtij anëtari ratifikohet nga mbledhja më e afërt e ardhshme e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve. Proçedura për njoftimin dhe paraqitjen e kandidaturave për zgjedhjen e anëtarëve të rinj, në këtë rast nuk do të jetë ajo e parashikuar në nenin 13.1 dhe 13.2 të këtij statuti. Ato do t'i paraqiten Kryetarit të Këshillit Drejtues menjëherë pas njoftimit të rendit të ditës deri në ditën e mbledhjes së Asamblesë.

23.4 Mandati i anëtarit të zgjedhur sipas paragrafit 23.3 përfundon së bashku me mandatin e anëtarit të mëparshëm që ka zëvendësuar

23.5 Këshilli Drejtues përcakton procedurën e paraqitjes së kandidaturës dhe zgjedhjen e Kryetarit dhe Zv/Kryetarit të KD

KAPITULLI V

Komiteti i Kontrollit të Brendshëm (Komiteti i Auditimit)

Neni 24

24.1 Komiteti i Kontrollit të Brendshëm përbëhet nga të paktën dy anëtarë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve për një periudhë katërvjeçare me të drejtë rrizgjedhje deri në 2 herë rradhazi.

24.2 Anëtarët e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm zgjidhen me votim të fshehtë në bazë të paraqitjes individuale të kandidaturave. Kryetar i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm caktohet kandidati që fiton numrin më të madh të votave dhe në rast votash të barabarta, kandidati që ka më shumë vite eksperiencë në profesionin e audituesit ligjor.

24.3 Kandidaturat për postin e anëtarit të Komitetit të Kontrollit të Brendshëm duhet t'i paraqiten Kryetarit të Këshillit Drejtues në përputhje me nenin 13.2 të paktën 25 ditë përpara datës së mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë e cila ka në rendin e ditës zgjedhjen e anëtarëve të këtij organi.

24.4 Anëtarët e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm shkarkohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve në rastet kur veprimet apo mosveprimet e tyre, të cilat bien ndesh me statutin, ligjin dhe rregullat, kur kanë cënuar rëndë reputacionin e profesionit të audituesit ligjor dhe të Institutit.

24.5 Anëtari i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm e humbet automatikisht cilësinë e tij si anëtar në rastet kur pushon së qëni anëtar i Institutit dhe ndëshkohet me masë disiplinore pezullim për një periudhë kohe të caktuar.

24.6 Shkarkimi i anëtarit të Komitetit të Kontrollit të Brendshëm bëhet nga mbledhja e më afërt e ardhshme e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve, e cila përfshin në rendin e ditës shkarkimin e anëtarëve të Komitetit të Kontrollit të Brendshëm.

24.7 Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve e thirrur sipas nenit 24.6 do të zgjedhë dhe zëvendësuesin e anëtarit të shkarkuar. Proçedura për njoftimin e vendeve vakante dhe paraqitjen e kandidaturave në këtë rast nuk do të jetë ajo e parashikuar në nenin 13.1 dhe 13.2. Ato do t'i paraqiten Kryetarit të Këshillit Drejtues menjëherë pas njoftimit të rendit të ditës deri në ditën e mbledhjes së Asamblesë.

Mandati i anëtarit të zgjedhur në përputhje me këtë nen do të përfundojë së bashku me mandatin e anëtarit të mëparshëm që ai/ajo zëvendëson.

24.8 Në rast vdekje ose pengimi të veprimtarisë së anëtarit të Komitetit të Kontrollit të Brendshëm në kryerjen e detyrave që i janë caktuar nga ligji, statuti, apo nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, anëtari ekzistues i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm mund të zëvendësohet deri në mbledhjen e ardhshme të Asamblese, që duhet të thirret në përputhje me dispozitat e nenit 9.4 të statutit, nga anëtari i Institutit i cili ka paraqitur kandidaturën në zgjedhjet e fundit dhe ka fituar numrin më të madh të votave pas kandidatit të zgjedhur në këtë post.

Neni 25

Komiteti i Kontrollit të Brendshëm ka për detyrë:

25.1 Të kontrollojë veprimtarinë financiare të Institutit, mbikëqyrë zbatimin e procedurave kontabël, pajtueshmërinë e veprimeve të regjistruara në llogari me buxhetin si dhe rregullsinë dhe korrektësinë e llogarive vjetore të aprovuara nga Këshilli Drejtues.

25.2 Të propozojë audituesin ligjor i cili do të auditojë pasqyrat financiare të Institutit dhe të mbajë marrëdhëniet ndërmjet tij dhe personelit të Institutit.

25.3 Bën vlerësimin e situatës financiare të Institutit, bazuar në raportin e audituesit ligjor;

25.4 I jep mendim Këshillit Drejtues për të gjitha problemet që i kërkohen prej këtij të fundit;

25.5 Komiteti i Kontrollit të Brendshëm i paraqet Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve një raport vjetor që nënshkruhet bashkërisht nga anëtarët e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm. Në rast mosmarrëveshje secili anëtar paraqet veçmas mendimet dhe vlerësimet e tij në Asamblenë e Përgjithshme të Anëtarëve, e cila merr vendimin përfundimtar në lidhje me çështjen.

KAPITULLI VI

Drejtori Ekzekutiv

Neni 26

26.1 Veprimtaritë administrative të Institutit udhëhiqen nga Drejtori Ekzekutiv.

26.2 Drejtori Ekzekutiv siguron që buxheti i Institutit është në përputhje me rregullat e administrimit financiar të miratuara nga Këshilli Drejtues. Ai është përgjegjës për organizimin e mbajtjes së llogarive dhe të raportimit financiar, në përputhje me politikën e caktuar nga Këshilli Drejtues dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

26.3 Drejtori Ekzekutiv organizon punën për kryerjen e veprimtarive profesionale të Institutit të cilat janë në përputhje me Ligjin apo me vendimet e Këshillit Drejtues. Këtu përfshihen ndjekja dhe organizimi i punës për përditësimin dhe plotësimin e standardeve profesionale, ndihma që i jepet autoriteteve, komiteteve e komisioneve të ngritura në përputhje me Ligjin, me vendimet të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, Asamblesë së Përgjithëshme të Anëtarëve apo Këshillit Drejtues, për kryerjen e veprimtarisë së tyre.

26.4 Me autorizim të Kryetarit të Këshillit Drejtues, Drejtori Ekzekutiv përfaqëson Institutin në veprimtaritë, që kanë të bëjnë me çështje të administrimit, zhvillimit profesional dhe institucional.

26.5 Brenda 20 ditëve nga fundi i çdo tremujori ai i paraqet Këshillit Drejtues raport mbi :

- Gjendjen financiare të institutit, realizimin e buxhetin faktik të shoqëruar me pasqyrat financiare periodike.
- Veprimtarinë teknike e profesionale, në zbatim të programit të punës dhe të vendimeve të Këshillit Drejtues.

26.6 Drejtori Ekzekutiv, me kërkesë të Kryetarit të Këshillit Drejtues, kryen detyra të tjera, të cilat nuk janë përmendur më sipër, dhe që lidhen me veprimtarinë dhe forcimin institucional të Institutit.

26.7 Drejtori Ekzekutiv asiston përmes personelit të Institutit kryerjen e veprimtarive të komiteteve dhe autoriteteve të ndryshme.

26.8 Drejtori Ekzekutiv siguron që anëtarët e Këshillit Drejtues të informohen për zhvillimet profesionale kombëtare, ndërkombëtare dhe rajonale, përfshirë punën që kryhet nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) dhe Fondacioni i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASCF).

26.9 Drejtori Ekzekutiv, në konsultim me Kryetarin e Këshillit Drejtues, emëron dhe drejton personelin ekzekutiv të Institutit, në pajtim me organigramën e miratuar nga Këshilli Drejtues. Ai harton përshkrime të detajuara të punës për çdo pozicion si dhe i propozon Këshillit Drejtues modele të vlerësimit të performancës.

Neni 27

27.1 Drejtori Ekzekutiv, emërohet nga Këshilli Drejtues i Institutit për një mandat 4 vjeçar me të drejtë riemërimi.

27.2 Kandidatët për Drejtor Ekzekutiv shprehin interesin duke plotësuar aplikimin dhe paraqitur dokumentacionin, sipas përcaktimeve të bëra nga Këshilli Drejtues. Paraqitja e aplikimeve bëhet pas shpalljes së njoftimit për konkurim, në të cilin përcaktohen detaje të dokumentacionit dhe afatet përkatëse, përfshirë datën kur kandidaturat që plotësojnë kriteret shqyrtohen nga mbledhja e Këshillit Drejtues..

27.3 Individët që paraqesin kandidaturën e tyre për postin e Drejtorit Ekzekutiv të Institutit duhet të plotësojnë këto kritere :

- Të ketë figurë të pastër morale;
- Të kenë njohuri në fushën e administrimit të entiteteve jo fitimprurëse;
- Të zotërojnë një gjuhë të huaj të vendeve të BE-së, preferohet gjuha angleze;
- Të ketë diplomë të shkollës së lartë në njerën nga drejtimet e ekonomisë, kontabilitetit, ose jurisprudencës;
- Të ketë eksperiencë pune në drejtim jo më pak se sa 7 vjet.

Këshilli Drejtues mund të përcaktojë kritere të tjera shtesë që lidhen me natyrën e fushës profesionale.

Procedura të detajuara të përzgjedhjes përcaktohen nga Këshilli Drejtues.

Neni 28

28.1 Këshilli Drejtues shkarkon Drejtorin Ekzekutiv në këto raste:

(a) kur me veprimet apo mosveprimet e tij janë dëmtuar rëndë reputacioni i profesionit të audituesit ligjor dhe të Institutit.

(b) kur ka shkelje të rënda të dispozitave të këtij statuti dhe të vendimeve të Asamblesë apo Këshillit Drejtues, të cilat dëmtojnë ndjeshëm reputacionin e Institutit dhe pengojnë arritjen e objektivave të tij.

28.2 Në rast të shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv për shkaqet e përcaktuara në pikën 28.1, si dhe në rast vdekje ose dorëheqje të Drejtorit Ekzekutiv, Këshilli Drejtues mund të komandojë në detyrën e Drejtorit Ekzekutiv një individ tjetër, i cili përmbush kriteret e parashikuara në nenin 27.3 të këtij statuti.

28.3 Drejtori Ekzekutiv i komanduar i paraqitet nga Kryetari i Këshillit Drejtues për miratim Këshillit Drejtues jo më vonë se në mbledhjen e cila duhet të thirret brenda 6 muajve nga data e komandimit të Drejtorit Ekzekutiv.

KAPITULLI VII

Kuotat Profesionale, Buxheti dhe Raportimi Financiar

Neni 29

29.1 Kuotat e detyrueshme vjetore të pagesës për anëtarësinë përbëhen nga një kuotë fikse që paguhet nga individët anëtarë të IEKAs dhe një kuotë variabel që paguhet nga shoqëritë e auditimit dhe personat fizikë, të cilat caktohen respektivisht:

- a. Anëtarët aktive, pavarësisht nga forma e ushtrimit të profesionit paguajnë një shumë fikse, masa e të cilës propozohet nga Këshilli Drejtues dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve. Kjo shumë nuk mund të jetë më e ulët se 60,000 lekë
- b. Anëtarët jo-aktivë që nuk janë regjistruar për të ushtruar profesionin, ose janë tërhequr pasi kanë qenë të regjistruar, paguajnë një shumë fikse, masa e të cilës propozohet nga Këshilli Drejtues dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve. Kjo shumë nuk mund të jetë më e vogël se 6 mijë lekë. Në rast të caktimit të një shume më të madhe se 10.000, vendimi i asamblesë duhet të ketë konsensusin e të paktën gjysmës së anëtarësisë që nuk e ushtron profesionin.

- a. Ekspertët e tërhequr si kontabilistë 12,000 lekë
- b. Shoqëritë e auditimit dhe personat fizikë paguajnë një shumë që llogaritet në një përqindje mbi totalin e qarkullimit vjetor, niveli minimum i të cilës nuk mund të jetë më poshtë se 0.25%
- c. Shumat si më sipër llogariten në proporcion me kohën që individi apo shoqëria dhe personi fizik kanë qenë aktiv në ushtrimin e profesionit gjatë vitit.

29.2 Asambleja e Përgjithshme miraton çdo vit formulën dhe shumën e kuotës fikse, përqindjen dhe bazën e llogaritjes së kuotës variabël.

29.3 Kuotat janë të pagueshme në muajin që caktohet nga Këshilli Drejtues. Për çdo muaj vonesë në pagimin e kuotës do të zbatohet një kamatë vonesë prej 1% në muaj mbi shumën e kuotës së papaguar.

29.4 Në rast të mospagimit të kuotës për një periudhë prej më shumë se 6 muaj nga data e pagesës, Këshilli Drejtues i propozon Bordit të Mbikëqyrjes Publike pezullimin e audituesit ligjor nga drejta e ushtrimit të profesionit dhe heqjen e tij nga regjistri publik.

29.5 Anëtarët që largohen, për çfarëdo arsye qoftë, janë të detyruar të paguajnë kuotën fikse përpjestimisht me kohën nga fillimi i vitit deri në muajin e largimit dhe kuotën variabël për misionet që kanë kryer.

Neni 30

30.1 Përpara fundit të muajit Shkurt të çdo viti, Drejtori Ekzekutiv i paraqet Këshillit Drejtues pasqyrat financiare të Institutit për vitin e mbyllur të cilat duhet të japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë, të gjendjes financiare, të të ardhurave dhe të shpenzimeve për vitin e mbyllur.

30.2 Këshilli Drejtues miraton pasqyrat financiare të paraqitura nga Drejtori Ekzekutiv dhe ia paraqitet ato për miratim Asamblesë së Përgjithshme.

30.3 Të paktën 60 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithëshme të Anëtarëve pasqyrat financiare duhet të jenë të audituara nga një auditues ligjor, i cili duhet të depozitojë pasqyrat financiare të audituara 30 ditë para mbledhjes së Asamblesë.

30.4 Pasqyrat financiare vjetore, raporti i Komitetit të Kontrollit si dhe projekt buxheti miratohen nga mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve.

Neni 31

Votimi i buxhetit bëhet për totalin e të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

Neni 32

Teprica e të ardhurave mbi shpenzimet e çdo viti mbartet në vitin e ardhshëm ose mund të kalojë në rezervën e përgjithshme apo në një rezervë të posaçme të Insitutit, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithëshme të Anëtarëve. Në rast se për një vit shpenzimet rezultojnë më të mëdha se të ardhurat, mbetja deficiitare kalon në pakësim të rezervës ose mbartet në ustrimin e ardhshëm sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve.

Neni 33

Për sa nuk është parashikuar në këtë statut zbatohet legjislacioni përkatës në fuqi, në vecanti Ligji nr. 10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar me Ligjin 47/2016 dhe Ligji 8788 datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimpruese" i ndryshuar.

Neni 34

Mosmarrëveshjet të cilat mund të lindin ndërmjet anëtarëve, ndërmjet tyre dhe Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve, Këshillit Drejtues dhe/ose Drejtorit Ekzekutiv ose ndërmjet organeve

drejtuese të Institutit, zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët kanë të drejtë ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky statut u redaktua në 6 kopje, secila me vlerë të njëjtë nga të cilat një kopje depozitohet në zyrën e notarisë Tiranë, dhe pas miratimit nga Ministri i Financave (me Vendimin Nr. 133 datë 27.12.2018) një kopje depozitohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe kopjet e tjera ruhen në selinë e Institutit.